

UDHËZIM
Nr. 8, datë 7.1.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM NR. 93, DATË 27.5.2024, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE
TË DOKUMENTACIONIT QË PARAQITET PËR APLIKIMIN DHE PAJISJEN E
SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË ZAKONSHME”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 93, datë 27.5.2024, “Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

1. Në nenin 5, pika 4, pas togfjalëshit “...me procedurë të përshpejtuar,” shtohet togfjalëshi “...dhe me procedurë normale,”.

Neni 2

1. Në nenin 14, bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si vijon:

“Në zyrat e misionit diplomatik ose postit konsullor, asgjësimi i bandës MRZ dhe i dokumenteve shoqëruese të aplikimit kryhet nga vetë përfaqësia, në përputhje me nenin 13 të këtij udhëzimi.”;

b) Në pikën 2, fjalia e parë, riformulohet dhe ndryshon me këtë përmbajtje:

“Pasaportat biometrike të prodhuara, që gjenden në Zyrat e Shpërndarjes pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe/ose pranë zyrave të misioneve diplomatike ose posteve konsullore, ruhen të paktën për një periudhë 12-mujore, por jo më vonë se muaji dhjetor i vitit pasardhës, referuar vitit të prodhimit të pasaportës.”.

Neni 3

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana KOÇIU

